



ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

**RREGULLA PËR MBËSHTETJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË CILËN
ËSHTË LËSHUAR CERTIFIKATA E ORIGINËS DHE PROCEDURAT PËR
PRANIM NË SKEMËN MBËSHTETËSE**

Prishtinë, 29 dhjetor 2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë në përputhje me Nenin 14, paragrafin 2, nënparagrafin 2.16, dhe Nenin 25, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Ligji Nr. 03/L-185, në mbledhjen e mbajtur më 29.12.2010, miratoi Rregullën për Mbështetjen e Energjisë Elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës dhe Procedurat për Pranim në Skemën Mbështetëse (në vazhdim: Rregulla).

Neni 1

Objektivi dhe fushëveprimi

- 1 Rregulla përcakton Skemën për Mbështetjen e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Ripërtërishme, për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës, sipas Nenit 9 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Nr. 03/L-201.
- 2 Skema e përcaktuar në këtë Rregull ka për qëllim përkrahjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë, në mënyrë që të arrihen Caqet Indikative për konsumin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për Energjinë, sipas Nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-184 për Energjinë.
- 3 Rregulla përmban dispozita për:
 - (a) përcaktimin e nivelit të kapacitetit gjenerues të nevojshëm për arritjen e Caqeve Indikative për Konsumin e Energjisë Elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;
 - (b) kriteret dhe Procedurat për Pranim në Skemën Mbështetëse;
 - (c) të Drejtat dhe Detyrimet e Prodhuesve të Energjisë Elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës, e pranuar në Skemën Mbështetëse;
 - (d) të Drejtat dhe Detyrimet e Prodhuesve të Energjisë Elektrike, për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës, por që nuk janë pranuar në Skemën Mbështetëse;
 - (e) të Drejtat dhe Detyrimet e Furnizuesit Publik lidhur me Energjinë Elektrike, për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës;
 - (f) të Drejtat dhe Detyrimet e Operatorit të Pavarur të Sistemit Transmetues dhe Tregut (OPSTT) në skemën mbështetëse lidhur me energjinë elektrike nga burimet e ripërtërishme
 - (g) financimin e Skemës Mbështetëse;
 - (h) integrimin e energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë në sistemin e energjisë elektrike.

Neni 2

Përkufizimet

- 1 Në këtë Rregull vlejnë përkufizimet e dhëna në Nenin 2 të Ligjit Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë dhe në Nenin 2 të Ligjit Nr. 03/L-201 për Energjinë Elektrike.
- 2 Vlejnë po ashtu edhe përkufizimet në vijim:
 - (a) “Të Hyrat e Lejuara” nënkuptojnë të hyrat nga furnizimi me energji elektrike prej Furnizuesit Publik, të vlerësuara sipas dispozitave të Metodologjisë së Tarifave për sektorin e Energjisë Elektrike të vendosur nga ZRRE-ja, dhe në këtë mënyrë duke marrë në konsideratë nivelin e humbjeve joteknike të përcaktuara aty;

- (b) “Direktiva 2009/28/EC” nënkupton Direktivën 2009/28/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të datës 23 prill 2009, për Mbështetjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme dhe ndryshimin si dhe, rrjedhimisht, shfuqizimin e Direktivave 2001/77/EC dhe 2003/30/EC;
- (c) “ZRRE-ja” nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji, të themeluar me Ligjin nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë;
- (d) OSTT – nënkupton Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
- (e) OSSH- nënkupton Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes
- (f) “Njësi gjeneruese” nënkupton kombinimin e gjeneratorëve të lidhur fizikisht, turbinave dhe lëvizësve kryesorë të tjerë që operojnë së bashku në një lokacion të vetëm për prodhimin e energjisë;
- (g) “Caqet Indikative” nënkupton Caqet Indikative për Konsumin e Energjisë të prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, të vendosura nga Ministria e Energjisë dhe Minierave, sipas Nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-184 për Energjinë;
- (h) “Burime të ndërpritshme (intermitent) të ripërtërishme të energjisë” nënkupton energjinë nga era, energjinë solare, gjeotermike, energjinë nga valët e detit, baticat dhe energjinë nga hidrocentralet rrjedhëse;
- (i) “Gjenerues Publik” nënkupton prodhuesin e energjisë elektrike me anë të centralit me kapacitet të instaluar mbi 5MW që ka ekzistuar dhe ka qenë në operim deri më 30 qershor 2004;
- (j) “Furnizues Publik” nënkupton ndërmarrjen e energjisë elektrike të licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji për të kryer veprimtarinë e furnizuesit publik;
- (k) “Burime të Ripërtërishme të Energjisë” nënkupton burimet e ripërtërishme jo-fosile të energjisë, siç janë: era, energjia diellore, ujërat gjeotermale, energjia valore, energjia e ujit, bioenergjia, biomasa dhe biogazet që përdoren si burime për prodhimin e energjisë elektrike;
- (l) “Rifuqizimi” nënkupton riparimin e një njësie gjeneruese me zëvendësimin ose rindërtimin e pjesëve kryesore të saj që paraqesin të paktën 50% të vlerës së përgjithshme të njësisë, me qëllim të arritjes së performancës më të mirë ose zgjatjen e jetëgjatësisë së dobishme të saj;
- (m) “Fondi për Energjinë e Ripërtërishme” nënkupton një fond të krijuar dhe të drejtuar nga Operatori i Sistemit të Transmisionit për financimin e kostove të ndërlidhura me Skemën Mbështetëse dhe kosto të tjera që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj Rregulle;
- (n) “Skema Mbështetëse” nënkupton një sërë dispozitash për mbështetjen e energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë në Kosovë, të nevojshme për arritjen e Caqeve Indikative.

Neni 3

Caqet e Kapacitetit Gjenerues të Energjisë Elektrike

- 1 Bazuar në Caqet Indikative, brenda tridhjetë (30) ditëve të hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, ZRRE-ja përcakton:
 - (a) Burimet primare të energjisë së ripërtërishme që mund të përdoren për prodhimin e energjisë elektrike, në mënyrë që ajo të jetë e pranueshme në Skemën Mbështetëse.
 - (b) Nivelin e kapacitetit të instaluar për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme, të ndarë sipas burimeve të ndryshme primare të energjisë të identifikuar në pikën a, që është i nevojshëm për arritjen e Caqeve Indikative.
- 2 Në përcaktimin e nivelit të kapacitetit të instaluar të referuar në paragrafin 1(b):

- (a) Referencë u bëhet vlerave të Cazeve për vitin 2020 ose, në qoftë se vlerat për këtë vit nuk janë vendosur, vlerave të vitit më të afërt me vitin 2020 për të cilin vit janë përcaktuar vlerat;
 - (b) ZRRE-ja përcakton nivelin tipik të shkallës vjetore të prodhimit (MWh/MW) të teknologjive gjeneruese të energjisë elektrike që përdorin burime të ripërtërishme të energjisë.
- 3 ZRRE-ja azhuron përcaktimin e saj lidhur me Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, të cilave u referohet në paragrafin 1(a) dhe nivelet e kapacitetit të instaluar, të cilave u referohet në paragrafin 1(b) brenda tre [3] muajve të caktimit të Cazeve të reja.

Neni 4

Regjistrat që duhet të krijohen nga ZRRE-ja

- 1 Brenda 60 ditëve të hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, ZRRE-ja krijon:
- (a) Regjistrin e aplikacioneve për pranim në Skemën Mbështetëse të Energjisë Elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, të cilit i referohet në Nenin 7, paragrafi 4;
 - (b) Regjistrin e njësive gjeneruese të pranueshme në Skemën Mbështetëse, të cilit i referohet në Nenin 9, paragrafi 1.
 - (c) Regjistrin e njësive gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse, të cilit i referohet në Nenin 9, paragrafi 3.
- ZRRE-ja i menaxhon dhe i azhuron vazhdimisht regjistrat e lartpërmendur.

Neni 5

Kushtet e nevojshme për pranim në Skemën Mbështetëse

- 1 Një njësi gjeneruese kualifikohet për t'u pranuar në Skemën Mbështetëse në qoftë se:
- (a) ka hyrë operim më [30 qershor 2004] ose pas kësaj date;
 - (b) ndodhet në territorin e Kosovës;
 - (c) prodhon energji duke përdorur kapacitete gjeneruese me pajisje të reja;
 - (d) prodhon energji elektrike për të cilën lëshohet Certifikata e Origjinës:
 - i. Duke përdorur veçanërisht një ose më shumë burime primare të ripërtërishme të energjisë, të identifikuar nga ZRRE-ja sipas Nenit 3, paragrafi 1(a);
 - ii. Duke përdorur një apo më shumë burime të Ripërtërishme primare të energjisë të identifikuar nga ZRRE-ja sipas Nenit 3, paragrafi 1(a), në kombinim me burime të tjera primare të energjisë;
- 2 ZRRE-ja mund të përcaktojë, duke iu referuar burimeve të veçanta të Energjisë së Ripërtërishme, një nivel maksimal të fuqisë së instaluar të njësive gjeneruese të kualifikueshme për pranim në Skemën Mbështetëse.
- 3 Pavarësisht paragrafit 1, njësitë gjeneruese, të cilat janë zhvilluar me procedura konkurruese, duke përfshirë pa kufizim procedurat e tenderimit për kapacitete të reja gjeneruese nga BRE-të, nuk janë të kualifikueshme për Skemën Mbështetëse.
- 4 Njësitë gjeneruese, të cilat i nënshtrohen rifuqizimit, i cili çon në rritjen e fuqisë së instaluar, kualifikohen për pranim në Skemën Mbështetëse për fuqinë e instaluar shtesë, me kusht që kjo rritje e kapacitetit të përmbushë parakushtet e specifikuar në paragrafin 1 dhe në qoftë se ZRRE-ja, në pajtim me paragrafin 2, ka përcaktuar kufijtë për kapacitetin e instaluar të

njësive gjeneruese të kualifikueshme për pranim në Skemën Mbështetëse, fuqia e instaluar e njësisë gjeneruese pas rifuqizimit ende u përmbahet këtyre kufijve. Në këtë rast dispozitat në këtë Rregull vlejné për këtë kapacitet shtesë.

Neni 6

Çmimet njësi të aplikueshme për energjinë elektrike të prodhuar nga njësitë gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse

- 1 ZRRE-ja përcakton çmimet njësi të aplikueshme për energjinë elektrike të prodhuar nga njësitë gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse, duke përdorur Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, të përcaktuara sipas Nenit 3, paragrafi 1(a). Këto çmime mund të diferencohen në periudha të ndryshme kohore (koha në vit, koha në ditë) apo nga niveli i fuqisë së instaluar të njësisë gjeneruese.
- 2 Përveç nëse specifikohet ndryshe në vendimin me të cilin ZRRE-ja përcakton çmimet njësi të referuara në paragrafin 1, këto çmime njësi rregullohen çdo vit, më 1 janar, sipas normës së ndryshimit, përgjatë 12 muajve paraprak, në nivelin e “Çmimeve të produktit të brendshëm industrial – mallrat kapitale NACE Rev2)” indeksi për 15 vendet e Eurozonës (ea15), të publikuara nga Eurostati.
(<http://epp.eurostat.ec.europa.eu/tgm/table.do?tab=table&init=1&language=en&pcode=teisi050&plugin=1>).

Neni 7

Aplikimi për pranim në Skemën Mbështetëse

- 1 Operatori i një njësie gjeneruese, i cili i plotëson kriteret për t’u kualifikuar për pranim në Skemën Mbështetëse, të specifikuara në Nenin 5, ka të drejtë të aplikojë për përfshirjen e njësisë në Skemën Mbështetëse brenda dy viteve të hyrjes në operim të njësisë, ose në rastin e njësive që janë në operim gjatë kohës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi.
- 2 Aplikacioni me shkrim dorëzohet në ZRRE duke përdorur modelin që prezantohet në Shtojcën 1 dhe duhet të përmbajë:
 - (a) Emrin, adresën dhe detajet kontaktuese të operatorit që ka dorëzuar aplikacionin;
 - (b) Emrat e personit (personave) të autorizuar për të vepruar në emër të operatorit dhe për operatorin;
 - (c) Emrin, vendndodhjen dhe/apo çfarëdo informacioni tjetër, i cili është i mjaftueshëm për të identifikuar në mënyrë unike njësinë gjeneruese në lidhje me të cilën aplikohet përfshirja në Skemën Mbështetëse;
 - (d) Fuqinë e instaluar të njësisë gjeneruese dhe prodhimin e saj vjetor të pritshëm në kushte normale;
 - (e) Burimin (burimet) primar të Energjisë së Ripërtërishme të përdorur për prodhimin e energjisë elektrike nga njësia gjeneruese dhe, nëse është relevante, burim (burime) tjetër primar të energjisë të përdorur në kombinim.Aplikacioni duhet të shoqërohet me një diagram të njësisë gjeneruese dhe të përfshijë detajet e vendndodhjes së njehsorëve të eksportit (ndonjë nënstacion transformatori, shërbime ndihmëse apo njehsor të importit).
- 3 Në rastin e njësive gjeneruese të cilat akoma nuk janë në operim në kohën kur dorëzohet aplikacioni, aplikacioni mund të dorëzohet vetëm pas lëshimit nga ZRRE-ja të Njoftimit të Vendimit Preliminar, të referuar në Nenin 12 të Rregullës mbi Procedurën e Autorizimit për

Ndërtimin e Kapaciteteve të reja Gjeneruese, Linjave të Gazit, Linjave elektrike-energjetike të drejtpërdrejta dhe Tubacioneve të Drejtpërdrejta.

- 4 ZRRE-ja regjistron aplikacionin dhe të gjitha dokumentet shoqëruese dhe informacione të tjera në Regjistrin e aplikacioneve për pranim në Skemën Mbështetëse të Energjisë Elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, me specifikim të datës dhe kohës në të cilën janë marrë ato.
- 5 ZRRE-ja, në bazë të kërkesave të prezantuara nga aplikanti, vendos se cilat hollësi apo dokumente konsiderohen konfidenciale në përputhje me Rregullën mbi Informacionin Konfidencial dhe këto dokumente nuk bëhen publike dhe vendosen në një zonë me qasje të kufizuar të Regjistrit të referuar në paragrafin 4.
- 6 Të gjitha aplikacionet duhet të shoqërohen me dëshminë e pagesës së tarifës së pakthyeshme, të përcaktuar herë pas herë nga ZRRE-ja, e cila vihet për të mbuluar kostot e procesimit të aplikacionit nga ZRRE-ja.

Neni 8

Vlerësimi i aplikacioneve

- 1 Brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e aplikacionit për pranim në Skemën Mbështetëse, ZRRE-ja vlerëson korrektësinë dhe plotësinë e tij sipas dispozitave të Nenit 7. Në qoftë se aplikacioni vlerësohet pozitivisht, ZRRE-ja e informon aplikantin për rezultatin e këtij vlerësimi. Në qoftë se nevojiten dokumente shtesë, ZRRE-ja ia kërkon ato aplikantit duke kontaktuar një kohë të arsyeshme për dorëzimin e tyre.
- 2 Në rastin e aplikacioneve të sakta dhe të plota të dorëzuara për njësitë gjeneruese të cilat nuk janë ende në operim gjatë kohës që dorëzohet aplikacioni, aplikanti obligohet t'ia dërgojë OSTT një kopje të aplikacionit dhe të gjitha dokumenteve shoqëruese, duke përfshirë të gjitha ato dokumente të kërkuara nga ZRRE-ja pas dorëzimit fillestar të aplikacionit, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pasi është informuar nga ZRRE-ja për rezultatin pozitiv të vlerësimit të referuar në paragrafin 1. OSTT-ja brenda 60 ditëve të marrjes së kopjes së aplikacionit nga aplikanti bën vlerësimin e ndikimit të zhvillimit të njësisë gjeneruese të specifikuar në aplikacionin për operim të sigurt në sistemin e energjisë elektrike të Kosovës. Në rast të vlerësimit negativ, OSTT-ja jep arsye të bazuara mirë. Nëse njësia e re gjeneruese do të lidhet me rrjetin e shpërndarjes, vlerësimi bëhet edhe nga OSTT dhe nga OSSH, por përgjegjësinë për komunikimin e rezultateve të vlerësimit me ZRRE-në dhe me aplikantin e mban OSTT-ja.
- 3 Aplikanti ka të drejtë të paraqesë në ZRRE komentet e tij lidhur me vlerësimin e referuar në paragrafin 2, brenda tridhjetë (30) ditëve të njoftimit të rezultateve.
- 4 ZRRE-ja merr vendimin për aplikacionin brenda 60 ditëve të marrjes së rezultateve të vlerësimit të referuar në paragrafin 2, të cilat nuk janë detyruese për ZRRE-në. Brenda të njëjtës periudhë kohore, ZRRE-ja e informon aplikantin për vendimin e saj. Në rastin kur aplikacioni refuzohet, ZRRE-ja jep shpjegim të detajuar për arsyet që kanë çuar në këtë refuzim.
- 5 ZRRE-ja përcakton, në bazë të Metodologjisë së Taksave për Kycje, tarifat me të cilat OSTT dhe OSSH e ngarkojnë aplikantin për vlerësimin të referuar në paragrafin 2.

Neni 9

Pranimi në Skemën Mbështetëse

- 1 Në qoftë se ZRRE-ja vendos pozitivisht për aplikacionin, aplikacioni pranohet dhe njësia gjeneruese konsiderohet për pranim në Skemën Mbështetëse. Në këtë rast, njësia gjeneruese regjistrohet në Regjistrin e Njësive Gjeneruese të Pranueshme në Skemën Mbështetëse, duke shënuar datën dhe kohën kur janë dorëzuar aplikacioni dhe dokumentet e tjera shtesë të kërkuara nga ZRRE-ja.
- 2 Njësitë gjeneruese të regjistruara në Regjistrin e referuar në Paragrafin 1 prانهen në Skemën Mbështetëse përkohësisht:
 - (a) Sipas rendit kronologjik të dorëzimit të aplikacioneve të plota dhe korrekte apo të dokumenteve shtesë të kërkuara nga ZRRE-ja, siç janë regjistruar në Regjistrin e referuar në paragrafin 1;
 - (b) Për çdo burim primar të Energjisë së Ripërtërishme, deri në nivelin e kapacitetit të instaluar të nevojshëm për të përmbushur Caqet Indikative, ashtu siç përcaktohen nga ZRRE-ja sipas Nenit 3, paragrafi 1, duke pasur parasysh kapacitetin e instaluar të njësisë gjeneruese tashmë të pranuar, edhe përkohësisht, në Skemën Mbështetëse.
- 3 Pranimi në Skemën Mbështetëse, edhe përkohësisht, bëhet për kapacitet të plotë të instaluar të njësisë gjeneruese apo në rastin e rifuqizimit, për të gjithë kapacitetin shtesë.
- 4 Përrjashtimisht nga paragrafi 2(b), një njësi gjeneruese specifike pranohet në Skemën Mbështetëse, në qoftë se gjithsej kapaciteti i instaluar i të gjitha centraleve që përdorin të njëjtin burim primar të energjisë së ripërtërishme të pranuar në Skemën Mbështetëse, duke përfshirë kapacitetin e njësisë specifike gjeneruese, nuk e tejkalon 110% të nivelit të kapacitetit të instaluar, për të njëjtin burim primar të energjisë së ripërtërishme të nevojshme për arritjen e Caqeve Indikative, siç përcaktohet nga ZRRE-ja, në pajtim me Nenin 3, paragrafi 1.
- 5 Përrjashtimisht nga paragrafi 2:
 - (a) Në qoftë se kapaciteti total i njësive gjeneruese që përdorin një burim specifik primar të Energjisë së Ripërtërishme, të pranuar në Skemën Mbështetëse, edhe përkohësisht, arrin të paktën 90% të nivelit të kapacitetit të instaluar të burimeve primare të nevojshme për arritjen e Caqeve Indikative siç përcaktohet nga ZRRE-ja në pajtim me Nenin 3, paragrafi 1, ZRRE-ja mund të mos pranojë njësi gjeneruese shtesë në Skemën Mbështetëse, ose mund t'i pranojë sipas radhës jokronologjike të dorëzimit të aplikacionit të plotë, në qoftë se pranimi sipas radhës kronologjike do të rezultonte me tejkalimin e nivelit të lartpërmendur të kapacitetit të instaluar të përcaktuar nga ZRRE-ja për më shumë se 10%;
 - (b) Njësitë gjeneruese me kapacitet të instaluar më të lartë se 20% [Shënim: duhet të jetë e njëjtë me diferencën ndërmjet dy vlerave në % të paragrafit 5(a)] të nivelit të kapacitetit të instaluar për burimin primar të energjisë të nevojshëm për arritjen e Caqeve Indikative siç janë përcaktuar nga ZRRE në pajtim me Nenin 3, paragrafi 1, mund të mos prانهen, edhe përkohësisht, edhe nëse ato do të konsideroheshin me të drejtë për t'u pranuar sipas parimit të radhës kronologjike të referuar në paragrafin 2(a), në qoftë se pranimi i tyre do të rezultonte me tejkalimin e nivelit të mësipërm të kapacitetit të instaluar të përcaktuar nga ZRRE-ja për më shumë se 10%.

- 6 Njësitë gjeneruese, të cilat pranohen përkohësisht në Skemën Mbështetëse në pajtim me paragrafët 2, 4 dhe 5, regjistrohen në Regjistrin e njësive gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse.
- 7 Njësitë gjeneruese, të cilat pranohen përkohësisht në Skemën Mbështetëse në pajtim me paragrafët 2, 4 dhe 5, duhet të postojnë një garanci sipas dispozitave të Nenit 10. ZRRE-ja e informon operatorin e njësisë gjeneruese të pranuar përkohësisht në Skemën Mbështetëse për shumën e garancisë që duhet të postohet, në mënyrë që pranimi në Skemën Mbështetëse të konfirmohet. Kjo shumë duhet të jetë ekuivalente me pagesën totale që njësia gjeneruese ka të drejtë të marrë, sipas Skemës së Mbështetjes gjatë periudhës prej 3 muajsh, duke marrë parasysh:
 - (a) Çmimet njësi të aplikueshme për energjinë elektrike të prodhuar nga burimi primar i energjisë së përdorur nga njësia gjeneruese, siç specifikohet nga ZRRE-ja në pajtim me Nenin 6 dhe në fuqi në kohën në të cilën aplikacioni i plotë për pranim në Skemën Mbështetëse apo ndonjë dokument shtesë është marrë nga ZRRE-ja;
 - (b) Kapacitetin e instaluar të njësisë gjeneruese;
 - (c) Shkallën e prodhimit vjetor për teknologjitë e gjenerimit që përdorin burimin (burimet) primar të Energjisë së Ripërtërishme të përdorur nga njësia gjeneruese siç përcaktohet nga ZRRE-ja në pajtim me Nenin 3, paragrafi 2(b).
- 8 Në rastin e njësive gjeneruese që ende nuk janë në operim në kohën e dorëzimit të aplikacionit për pranim në Skemën Mbështetëse, ZRRE-ja gjithashtu përcakton datën deri në të cilën njësia gjeneruese duhet të hyjë në operim. Pranimi në Skemën Mbështetëse konfirmohet vetëm nëse njësia gjeneruese futet në operim dhe në qoftë se kjo ndodh jo më vonë se data e përcaktuar nga ZRRE-ja. Afati i fundit kohor për hyrjen në operim mund të shtyhet vetëm në qoftë se operatori i njësisë gjeneruese mund t'i demonstrojë ZRRE-së që vonesa në ndërtimin e njësisë gjeneruese apo të kyçjes së njësisë gjeneruese me rrjetin, ka ndodhur për shkaqe jashtë kontrollit të operatorit apo të entiteteve, të cilat janë ligjërish apo në baza kontraktuale të ndërlidhura me operatorin.
- 9 Operatori i njësisë gjeneruese informon ZRRE-në dhe subjektet e tjera si: OSTT, OSSH dhe furnizuesin publik për datën e hyrjes në operim të njësisë gjeneruese.
- 10 Mosparaqitja e garancisë brenda afatit dhe në përputhje me dispozitat e specifikuara në Nenin 10, paragrafi 1 dhe 2, rezulton me përjashtimin e njësisë gjeneruese nga Skema Mbështetëse dhe fshirjen e kësaj njësie gjeneruese nga Regjistri i Njësive Gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse.
- 11 Në qoftë se njësia gjeneruese, e cila nuk është në operim në kohën kur dorëzohet aplikacioni për pranim në Skemën Mbështetëse dhe e cila është e pranuar përkohësisht në Skemën Mbështetëse, nuk arrin të hyjë në operim në datën e përcaktuar nga ZRRE-ja, në pajtim me paragrafin 8, ajo përjashtohet nga Skema Mbështetëse dhe çregjistrohet nga Regjistri i njësive gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse.
- 12 Njësitë gjeneruese të regjistruara në Regjistrin e njësive gjeneruese të pranueshme në Skemën Mbështetëse mbahen në Regjistër dhe janë të kualifikueshme për t'u përfshirë në Skemën Mbështetëse, në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafët 2, 4 dhe 5, për aq kohë sa ato janë në operim. Në rastin e njësive gjeneruese, të cilat akoma nuk janë në operim në kohën kur dorëzohet aplikacioni për pranim në Skemën Mbështetëse, ato mbahen në Regjistër dhe kualifikohen për t'u përfshirë në Skemën Mbështetëse për një

periudhë trevjeçare. Nëse njësia gjeneruese hyn në operim brenda kësaj periudhe, atëherë vlen fjalia e parë e këtij paragrafi.

Neni 10

Garancitë

- 1 Garancia e referuar në Nenin 9, paragrafi 7, duhet të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditëve të komunikimit nga ZRRE-ja, për shumën dhe në formatin e specifikuar nga ZRRE-ja.
- 2 Garancia duhet të lëshohet nga një bankë me organizim të qëndrueshëm në Kosovë.
- 3 Garancia do të jetë e vlefshme për një periudhë kohore që përfundon 10 vjet pas datës në të cilën konfirmohet pranimi i njësisë gjeneruese në Skemën Mbështetëse. Nëse garancia e paraqitur është e vlefshme për një periudhë më të shkurtër, një garanci e re për një periudhë shtesë duhet të dërgohet jo më vonë se tridhjetë [30] ditë para datës në të cilën skadon vlefshmëria e garancisë së mëparshme. Në rast se garancia e re nuk dorëzohet brenda afatit kohor të përcaktuar, garancia ekzistuese ekzekutohet dhe njësia gjeneruese përjashtohet menjëherë nga Skema Mbështetëse.
- 4 Pranimi në Skemën Mbështetëse mund të konfirmohet vetëm kur operatori siguron garancinë e nevojshme.
- 5 Garancitë e dorëzuara nga operatorët e njësive gjeneruese të pranuar, edhe përkohësisht, në Skemën Mbështetëse mbahen nga Furnizuesi Publik.
- 6 Nëse një njësi gjeneruese e pranuar përkohësisht në Skemën Mbështetëse nuk fillon operimin në datën e përcaktuar nga ZRRE-ja në përputhje me Nenin 9, paragrafi 8, garancia e postuar nga operatori i asaj njësie ekzekutohet, siç përcaktohet në Nenin 9, paragrafi 7.
- 7 Garancia e dorëzuar nga operatorët e njësive gjeneruese të pranuar, qoftë edhe përkohësisht, në Skemën Mbështetëse, nëse nuk ekzekutohet, lirohet dhe i kthehet operatorit:
 - (a) Në fund të periudhës të referuar në Nenin 13, paragrafi 1.
 - (b) Nëse operatori i njësisë gjeneruese kërkon përjashtimin e njësisë nga Skema Mbështetëse, në përputhje me Nenin 11, paragrafi 1, përjashtimi miratohet dhe nuk ka më detyrime.

Neni 11

Përjashtimi nga Skema Mbështetëse

- 1 Pavarësisht nga rasti i referuar në Nenin 9, paragrafi 11, Neni 11, paragrafi 3 dhe Neni 13, paragrafi 10, një njësi gjeneruese e pranuar, edhe përkohësisht, në Skemën Mbështetëse mund të përjashtohet nga Skema me anë të një kërkesë me shkrim të operatorit të saj drejtuar ZRRE-së.
- 2 ZRRE-ja konfirmon përjashtimin e njësisë gjeneruese nga Skema Mbështetëse brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e kërkesës dhe fshin njësinë gjeneruese nga Regjistri i njësive të pranuar në Skemën Mbështetëse.
- 3 Përjashtimi i njësisë gjeneruese nga Skema Mbështetëse nuk e liron operatorin e njësisë gjeneruese nga detyrimet që rrjedhin nga pjesëmarrja e njësisë në Skemën Mbështetëse.

- 4 Një njësi gjeneruese, e cila përjashtohet nga Skema Mbështetëse, nuk lejohet të aplikojë për riparim në Skemë në ndonjë datë të mëvonshme.

Neni 12

Matja e energjisë elektrike për të cilën lëshohen Certifikatat e Origjinës

- 1 Njësitë gjeneruese të cilat prodhojnë energji elektrike për të cilën lëshohet Certifikata e Origjinës duhet të pajisen me një pajisje matëse, e cila mundëson matjen e sasisë së energjisë së prodhuar dhe të shpërndarë në rrjet, siç kërkohet nga Kodi i Matjes.
- 2 Operatori i Sistemit të Transmisionit ose, në rastin e njësisë gjeneruese të lidhur me rrjetin e shpërndarjes, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, është përgjegjës për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave të matjes për prodhimin e njësisë gjeneruese, e cila gjeneron energji elektrike për të cilën lëshohet Certifikata e Origjinës. Të dhënat e matjeve për çdo orë, të mbledhura dhe verifikuara nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit, i dërgohen Operatorit të Tregut më së voni 5 ditë pas ditës së operimit.
- 3 Në rastin e njësisë gjeneruese, e cila prodhon energji elektrike, siç referohet në Nenin 5, paragrafi 1(c)ii, Operatori i Sistemit të Transmisionit përcakton pjesën e energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, mbi bazë të sasisë relative të energjisë primare të Ripërtërishme dhe energjisë tjetër primare të përdorur nga njësia gjeneruese.
- 4 Operatorët e njësive gjeneruese duhet të sigurojnë informacionin e nevojshëm dhe të kërkuar nga Operatori i Sistemit të Transmisionit për të përmbushur detyrën e referuar në paragrafin 3.
- 5 Operatori i Tregut njofton Furnizuesin Publik dhe Operatorin e Njësive Gjeneruese, brenda dhjetë (10) ditëve të përfundimit të çdo muaji, për energjinë elektrike në lidhje me të cilën lëshohen Certifikatat e Origjinës, të hartuara gjatë muajit, mundësisht të diferencuara siç parashikohet në Nenin 6, paragrafi 1 dhe që i shiten Furnizuesit Publik në bazë të Marrëveshjeve për Blerje të Energjisë Elektrike, të cilave u referohet në Nenin 13, paragrafi 4 dhe Nenin 14, paragrafi 4.

Neni 13

Të drejtat dhe detyrimet e operatorëve të njësive gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse

- 1 Operatori i njësive gjeneruese i pranuar në Skemën Mbështetëse ka të drejtë të shesë energjinë elektrike të prodhuar nga burimi (burimet) i Ripërtërishëm i energjisë nga njësia gjeneruese tek Furnizuesi Publik sipas kushteve të specifikuara në këtë nen, për një periudhë 10 vjeçare nga data në të cilën është konfirmuar pranimi në Skemën Mbështetëse.
- 2 Në rastin e njësive gjeneruese, të cilat prodhojnë energji elektrike siç referohet në Nenin 5, paragrafi 1(c)ii, e drejta kufizohet në pjesën e prodhimit të tyre vjetor, ose prodhimit të tyre gjatë çfarëdo periudhe tjetër më të shkurtër për të cilat vlejnë kushtet uniforme, të përcaktuara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit, në përputhje me Nenin 12, paragrafi 3.

- 3 Për të ushtruar të drejtën e tij për t'i shitur energji elektrike Furnizuesit Publik siç përcaktohet në paragrafët 1 dhe 2, operatori i njësive gjeneruese duhet të dorëzojë aplikacion te Furnizuesi Publik.
- 4 Shitja e energjisë elektrike tek Furnizuesi Publik mbulohet nga Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike, e hartuar në përputhje me modelin e referuar në Nenin 15, paragrafi 1 (a), siç aprovohet nga ZRRE-ja në përputhje me Nenin 15, paragrafi 3. Brenda tridhjetë (30) ditëve të marrjes së aplikacionit të referuar në paragrafin 3, Furnizuesi Publik i dërgon operatorit të njësive gjeneruese një propozim për Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas marrjes së MBE-së, Operatori i njësive gjeneruese e nënshkruan dhe ia kthen një kopje Furnizuesit Publik. Shitja e energjisë elektrike te Furnizuesi Publik hyn në fuqi nga fillimi i muajit të dytë pas datës në të cilën merret kopja e firmosur e Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë elektrike nga Furnizuesi Publik.
- 5 Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga marrja e kopjes së firmosur të Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë Elektrike nga operatori i njësive së gjenerimit, Furnizuesi Publik e informon OSTT-në dhe, kur është relevante, edhe OSSH-në, për datën në të cilën hyn në fuqi Marrëveshja e Blerjes së Energjisë Elektrike, për të aktivizuar procedurën e mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave të njehsimit (matjes) si përcaktohet në Nenin 12.
- 6 Çmimi njësi i aplikueshëm për shitjen e energjisë elektrike tek Furnizuesi Publik është çmimi i përcaktuar, duke iu referuar burimit primar të Energjisë së Ripërtërishme të përdorur nga njësia, nga ZRRE-ja në përputhje me Nenin 6 dhe në fuqi në kohën kur është marrë nga ZRRE-ja aplikacioni i plotë për pranim në Skemën Mbështetëse, ose çfarëdo dokumenti shtesë. Ky çmim njësi rregullohet çdo vit, më 1 janar, në bazë të normës së ndryshimit, gjatë dymbëdhjetë muajve paraprijës, në "çmimet e prodhimit të brendshëm industrial - të mirat kapitale NACE Rev2" indeksi për 15 vendet e Eurozonës (ea15), të publikuara nga Eurostati (<http://epp.eurostat.ec.europa.eu/tgm/table.do?tab=table&init=1&language=en&pcode=teis050&plugin=1>).
- 7 Marrëveshjet e Blerjes së Energjisë të referuara në paragrafin 4 duhet të aprovohen nga ZRRE-ja për t'u siguruar se ato hartohen në përputhje me modelet e referuara në Nenin 15, dhe specifikojnë çmimet njësi të referuara në paragrafin 6.
- 8 Shitja e energjisë elektrike tek Furnizuesi Publik në bazë të Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë elektrike të referuar në paragrafin 4 i nënshtrohet Certifikatave të Origjinës, të cilat janë lëshuar në lidhje me të njëjtën energji elektrike. Me qëllim të përmbushjes së kërkesave të Direktivës 2009/28/EC, që ndërlidhen me projektet e përbashkëta midis shteteve anëtare dhe vendeve të botës së tretë, shitja e energjisë elektrike tek Furnizuesi Publik, sipas dispozitave të këtij neni, shpjegohet në përputhje me Certifikatat korresponduese të Origjinës si "energji elektrike në lidhje me të cilën është lëshuar kjo Certifikatë ka marrë mbështetjen nga Skema Mbështetëse në Kosovë".
- 9 Operatori i njësive gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse i dërgon faturën mujore Furnizuesit Publik, brenda njëzet ditëve të përfundimit të muajit, në bazë të informacionit të marrë nga Furnizuesi Publik në përputhje me Nenin 16, paragrafi 1(b). Faturat përgatiten në përfundim të muajit të tretë në vijim të muajit të cilit i referohen ato.
- 10 Njësitë gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse duhet t'i shesin çdo vit Furnizuesit Publik, nëpërmjet Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë elektrike të referuar në paragrafin 4, një sasi energjie elektrike jo më të vogël se 50% të maksimumit të prodhimit, të llogaritur në

bazë të kapacitetit të instaluar të tyre dhe normës së prodhimit vjetor të përcaktuar nga ZRRE-ja në përputhje me Nenin 3, paragrafi 2(b). Mospërmbushja e shkallës së prodhimit vjetor minimal të specifikuar në këtë paragraf për dy vite të njëpasnjëshme çon në ekzekutimin e garancisë, përjashtimin e njësisë gjeneruese nga Skema Mbështetëse dhe fshirjen e njësisë gjeneruese nga Regjistri i njësive të pranuar në Skemën Mbështetëse.

- 11 Gjeneratorët që prodhojnë energji elektrike nga BRE-të përjashtohen nga obligimi i pagesave në bazë të nominimeve që përcaktohet në Rregullat e Tregut.

Neni 14

Të drejtat dhe detyrimet e operatorëve të njësive gjeneruese, të cilat prodhojnë energji elektrike dhe për të cilat janë lëshuar Certifikatat e Origjinës, por që nuk janë pranuar në Skemën Mbështetëse

- 1 Operatorët e njësive gjeneruese, të cilët prodhojnë energji elektrike dhe kanë Certifikata të Origjinës, por të cilat nuk janë pranuar në Skemën Mbështetëse, duke përfshirë njësitë gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse pas skadimit të periudhës së referuar në Nenin 13, paragrafi 1, kanë të drejtë t'ia shesin Furnizuesit Publik energjinë elektrike për të cilën janë lëshuar Certifikatat e Origjinës sipas kushteve të specifikuara në këtë nen.
- 2 Në rastin e njësive gjeneruese të cilat prodhojnë energji elektrike, siç referohet në Nenin 5, paragrafi 1(c)ii, kjo e drejtë kufizohet në pjesën e prodhimit të tij vjetor ose prodhimit të tij në një periudhë më të shkurtër për të cilën vlejné kushtet uniforme, të përcaktuara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit në përputhje me Nenin 12, paragrafi 3.
- 3 Për të ushtruar të drejtën e tij për t'i shitur energji elektrike Furnizuesit Publik, siç përcaktohet në paragrafin 1 dhe 2, operatori i njësisë gjeneruese duhet të dorëzojë aplikacionin të Furnizuesi Publik.
- 4 Shitja e energjisë elektrike të Furnizuesi Publik bëhet me anë të Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë elektrike, të hartuar në përputhje me modelin e referuar në Nenin 15, paragrafi 1 (b), siç është aprovuar nga ZRRE në përputhje me Nenin 15, paragrafi 3. Brenda tridhjetë (30) ditëve të marrjes së aplikacionit të referuar në paragrafin 3, Furnizuesi Publik i dërgon operatorit të njësisë gjeneruese një Propozim-marrëveshje të Blerjes së Energjisë Elektrike. Operatori i njësisë gjeneruese e pranon propozimin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas marrjes së saj duke i kthyer Furnizuesit Publik një kopje të Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë të firmosur për pranim. Shitja e energjisë elektrike tek Furnizuesi Publik hyn në fuqi nga fillimi i muajit të dytë pas datës në të cilën merret nga Furnizuesi Publik kopja e firmosur e Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë elektrike ose, në rastin kur operatori është duke i shitur Furnizuesit Publik energji elektrike të prodhuar nga njësia gjeneruese në bazë të Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë Elektrike, nga data në të cilën kjo Marrëveshje skadon.
- 5 Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga marrja e kopjes së firmosur të Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë elektrike nga operatori i njësisë gjeneruese, Furnizuesi Publik e informon Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe, kur është relevante, edhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, për datën në të cilën hyn në fuqi Marrëveshja e Blerjes së Energjisë elektrike, për të aktivizuar procedurën e mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave të njehsimit (matjes) siç përcaktohet në Nenin 12.
- 6 Çmimi njësi i aplikueshëm për shitjen e energjisë elektrike të Furnizuesi është i barabartë me çmimin me të cilin Furnizuesi Publik do të mund të blinte një sasi ekuivalente të energjisë

elektrike nga prodhuesit publikë. Furnizuesit Publikë e përcaktojnë këtë çmim njësi dhe e përfshijnë atë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë Elektrike, të referuar në paragrafin 4, së bashku me një shpjegim përmbledhës për mënyrën si është përcaktuar ky çmim njësi.

- 7 Marrëveshjet e Blerjes së Energjisë, të referuara në paragrafin 4, duhet të aprovohen nga ZRRE-ja, për të siguruar se ato janë hartuar në përputhje me modelet e referuara në Nenin 15 dhe specifikojnë çmimet njësi, të referuara në paragrafin 6.
- 8 Shitja e energjisë elektrike tek Furnizuesi Publik në bazë të dispozitës së kësaj Rregulle i nënshtrohet Certifikatave të Origjinës, të cilat lëshohen në lidhje me të njëjtën energji elektrike.
- 9 Operatorët e njësive gjeneruese të referuara në paragrafin 1 faturojnë Furnizuesin Publik në bazë mujore, brenda njëzet ditëve të përfundimit të muajit, në bazë të informacionit të marrë nga Furnizuesi Publik në përputhje me Nenin 16, paragrafi 1(b). Faturat paguhen para fundit të muajit pas muajit të cilit i referohen.
- 10 Gjeneratorët që prodhojnë energji elektrike nga BRE-të përjashtohen nga obligimi i pagesave në bazë të nominimeve që përcaktohet në Rregullat e Tregut.

Neni 15

Marrëveshjet e Blerjes së Energjisë Elektrike

- 1 Brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, Furnizuesi Publik harton draft-modele Marrëveshjesh të Blerjes së Energjisë elektrike për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë:
 - (a) Nga njësitë gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse;
 - (b) Nga njësitë gjeneruese, të cilat prodhojnë energji elektrike dhe për të cilat lëshohen Certifikatat e Origjinës, por të cilat nuk janë pranuar në Skemën Mbështetëse, duke përfshirë dhe ato njësi gjeneruese që janë pranuar në Skemën Mbështetëse pas skadimit të periudhës së referuar në Nenin 13, paragrafi 1.Furnizuesi Publik publikon draft-modelet e Marrëveshjeve të Blerjes së Energjisë Elektrike në faqen elektronike të tij për konsultime me pjesëmarrës të interesuar, duke vendosur një periudhë të arsyeshme për dorëzimin e komenteve.
- 2 Marrëveshjet e Blerjes së Energjisë elektrike të referuara në paragrafin 1(a) kanë kohëzgjatje prej 10 vjetësh. Marrëveshjet e Blerjes së Energjisë elektrike të referuara në paragrafin 1(a) duhet të përfshijnë dispozita në bazë të të cilave njësia gjeneruese e pranuar në Skemën Mbështetëse zotohet se do të veprojë në përputhje me obligimet e dhëna në Nenin 13 përgjatë tërë kohëzgjatjes së Marrëveshjes. Marrëveshjet e Blerjes së Energjisë elektrike të referuara në paragrafin 1(b) zgjasin 1 vit dhe rinovohen për po të njëjtën periudhë.
- 3 Në përfundim të periudhës së konsultimit, Furnizuesi Publik dorëzon në ZRRE draft-modelet, mundësisht të rishikuara në bazë të komenteve të marra gjatë periudhës së konsultimit, si dhe të gjitha dorëzimet e tjera të tilla. ZRRE-ja bën aprovimin e modeleve. Duke e bërë këtë, ZRRE-ja mund ta udhëzojë Furnizuesin Publik që të bëjë ndryshime të tilla që konsideron se është e nevojshme.

Neni 16

Të drejtat dhe detyrimet e Furnizuesit Publik në lidhje me energjinë elektrike për të cilën janë lëshuar Certifikatat e Origjinës

- 1 Furnizuesi Publik e blen energjinë elektrike për të cilën janë lëshuar Certifikatat e Origjinës sipas dispozitave të kësaj Rregulle. Për këtë qëllim, Furnizuesi Publik është përgjegjës për:
 - (a) Përmbylljen e Marrëveshjeve të Blerjes së Energjisë elektrike të referuara në Nenin 13, paragrafi 4 dhe Nenin 14, paragrafi 4, pas aplikimit të operatorit të njësisë gjeneruese, sipas dispozitave të dhëna në Nenin 13, paragrafi 5.6 dhe 8 dhe Nenin 14, paragrafët 5,6 dhe 8.
 - (b) Informimin e operatorëve të njësisë gjeneruese, e cila shet energji elektrike te Furnizuesi Publik sipas dispozitave të kësaj Rregulle, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të përfundimit të çdo muaji, për energjinë elektrike për të cilën lëshohen Certifikatat e Origjinës dhe që i shiten gjatë muajit Furnizuesit Publik, mundësisht të diferencuar siç jepet në Nenin 6, paragrafi 1, edhe çmimin njësi të aplikueshëm dhe për shumën totale që do të faturohet;
 - (c) Pagesën e faturave të marra nga operatorët e njësive gjeneruese në lidhje me shitjen e energjisë sipas Marrëveshjeve të Blerjes së Energjisë elektrike të referuara në Nenin 13, paragrafi 4 dhe Nenin 14, paragrafi 4, brenda periudhës kohore të përcaktuar në Nenin 13, paragrafi 9 dhe Nenin 14, paragrafi 9, respektivisht.
- 2 Furnizuesi Publik e shfrytëzon energjinë elektrike për të cilën lëshohen Certifikatat e Origjinës dhe të blerë sipas Marrëveshjeve të Blerjes së Energjisë Elektrike të referuara në Nenin 13, paragrafi 4 dhe Nenin 14, paragrafi 4, për të furnizuar konsumatorët e paprivilegjuar. Furnizuesi Publik i jep përparësi energjisë elektrike për të cilën lëshohen Certifikatat e Origjinës dhe që blihet mbi bazë të Marrëveshjeve të lartpërmendura të Blerjes së Energjisë Elektrike. Në rast se volumi i energjisë elektrike të blerë në bazë të Marrëveshjeve të Blerjes së Energjisë Elektrike e tejkalon kërkesën për furnizim të konsumatorëve të rregulluar, Furnizuesi Publik e shet çdo tepriçë të energjisë elektrike në tregun e parregulluar, duke përdorur procedura objektive, transparente, jodiskriminuese dhe të mbështetura në treg. Rregullat për këto procedura aprovohen nga ZRRE-ja, me propozim të Furnizuesit Publik të paraqitur të paktën 90 ditë para fillimit të procedurave të përmendura.
- 3 Furnizuesit Publik duhet t'i mundësohet të mbulojë ndryshimin midis kostos së blerjes së energjisë elektrike mbi bazë të Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë elektrike të referuar në Nenin 13, paragrafi 4 dhe Nenin 14, paragrafi 4 dhe të hyrave të lejuara të marra nga furnizimi i kësaj energjie elektrike te konsumatorët e paprivilegjuar ose në tregun e parregulluar, neto e çfarëdo kostoje tjetër.
- 4 Furnizuesi Publik:
 - (a) Mban llogari të veçanta të kostove që lidhen me blerjen e energjisë elektrike mbi bazë të Marrëveshjeve të Blerjes së Energjisë Elektrike, të referuara në Nenin 13, paragrafi 4 dhe Nenin 14, paragrafi 4, dhe të të hyrave, neto e çfarëdo kostoje tjetër të lejuar, që rrjedh nga shitja e kësaj energjie elektrike;
 - (b) I dërgon ZRRE -së raport mujor:
 - i. Për sasinë e energjisë elektrike të blerë në bazë të Marrëveshjeve të lartpërmendura të Blerjes së Energjisë Elektrike, të diferencuar nga burimi primar i energjisë së ripërtërishme të përdorur për prodhimin e saj dhe për çmimet njësi të paguara;

- ii. Për kostot totale të blerjes së energjisë elektrike në bazë të Marrëveshjeve të lartpërmendura të Blerjes së Energjisë Elektrike.
- iii. Për të hyrat, neto e kostove të tjera, të marra nga shitja e energjisë elektrike të konsumatorët e rregulluar të referuar në pikën 1;
- iv. Për të hyrat, neto e kostove të tjera, të marra nga çdo shitje e energjisë elektrike të referuar në pikën I në tregun e parregulluar, në përputhje me paragrafin 2.

Raporti dërgohet brenda tridhjetë (30) ditëve të përfundimit të muajit përkatës;

- (c) I dërgon ZRRE-së, çdo vit (deri më 30 shtator) një raport për parashikimet e tij më të sakta për vitin vijues, të sasisë, kostove dhe të hyrave të referuara në paragrafin (b);
- (d) I dërgon ZRRE -së një raport tremujor, i cili përmban vlerësimet më të sakta, për çdo muaj të tremujorit dhe për secilin nga tre tremujorët në vijim, për sasi të, kostot dhe të hyrat e referuara në paragrafin (b). Raporti dërgohet të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të tremujorit, të cilit ai i referohet.

Neni 17

Informacioni i bërë publik nga ZRRE-ja

- 1 ZRRE-ja publikon në faqen elektronike të saj:
 - (a) Listën e burimeve primare të Energjisë së Ripërtërishme të përcaktuara në përputhje me Nenin 3, paragrafi 1(a), të cilat mund të përdoren nga njësia gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë, në mënyrë që kjo njësi të jetë e kualifikueshme për pranim në Skemën Mbështetëse;
 - (b) Informacionin për nivelin e kapacitetit të instaluar për çdo burim primar të Energjisë së Ripërtërishme, që nevojitet për arritjen e Ceqeve Indikative, siç përcaktohet sipas Nenit 3, paragrafi 1 (b).
 - (c) Për çdo burim primar energjie të referuar në Nenin 3, paragrafi 1 (a), kapacitetin e përgjithshëm të të gjitha njësive gjeneruese që përdorin këtë burim primar të energjisë, të cilat janë pranuar tashmë në Skemën Mbështetëse, duke specifikuar se cila pjesë e këtij kapaciteti është pranuar përkohësisht. Ky informacion mbahet i azhurnuar në mënyrë të vazhdueshme;
 - (d) Regjistrin e aplikacioneve për pranim në Skemën Mbështetëse të energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;
 - (e) Regjistrin e njësive gjeneruese të pranueshme në Skemën Mbështetëse;
 - (f) Regjistrin e njësive gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse.

Neni 18

Financimi i Skemës Mbështetëse

- 1 Operatori i Sistemit të Transmisionit themelon dhe operon Fondin (Llogarinë) e Energjisë së Ripërtërishme. Operatori i Sistemit të Transmisionit raporton çdo tremujor në ZRRE për operimin e Fondit të Energjisë së Ripërtërishme.
- 2 Fondi i Energjisë së Ripërtërishme përdoret për financimin e kostove që lidhen me:
 - (a) Diferencën e referuar në Nenin 16, paragrafi 3;
 - (b) Dispozitat e dhëna në Nenin 19, paragrafi 3;
 - (c) Çdo aspekt tjetër të lidhur me zbatimin e kësaj Rregulle, nëse vendoset kështu nga ZRRE-ja.
- 3 Financimi i Fondit të Energjisë së Ripërtërishme sigurohet me anë të:

- (a) të ardhurave nga ekzekutimi i garancive, siç parashikohet në Nenin 10, paragrafi 6, dhe Nenin 13, paragrafi 10;
 - (b) një taksë shtesë (Tarifë e Energjisë së Ripërtërishme) e aplikueshme në nivel të transmisionit për të gjithë energjinë elektrike të furnizuar në Kosovë.
- 4 Niveli i mbitaksës përcaktohet nga ZRRE-ja dhe rregullohet kur është e nevojshme, në mënyrë që të sigurojë burime të mjaftueshme financiare për të mbuluar kostot e referuara në paragrafin 2, mbi bazë të parashikimeve dhe informacionit të siguruar nga Furnizuesi Publik, Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në përputhje me Nenin 16, paragrafi 4, dhe Nenin 19, paragrafi 5.
 - 5 Furnizuesi Publik i faturon Operatorit të Sistemit të Transmisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga përfundimi i çdo muaji, një shumë të barabartë me diferencën e referuar në Nenin 16, paragrafi 3. Operatori i Sistemit të Transmisionit e paguan faturën sipas disponueshmërisë së mjeteve në Fondin e Energjisë së Ripërtërishme.
 - 6 Furnizuesi Publik është përgjegjës për të parapaguar çfarëdo shume të nevojshme për të shlyer pagesën e faturave që lidhen me blerjen e energjisë elektrike për të cilën lëshohen Certifikatat e Origjinës në përputhje me dispozitat e Nenit 13, paragrafi 9 dhe Nenit 14, paragrafi 9.

Neni 19

Integrimi i energjisë elektrike në lidhje me të cilën lëshohen Certifikatat e Origjinës

- 1 Operatori i Sistemit të Transmisionit i jep përparësi dispeçimi energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, për të cilat lëshohen Certifikatat e Origjinës dhe, nga kjo, energjisë elektrike të prodhuar nga njësitë gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse.
- 2 Njësitë gjeneruese, të cilat prodhojnë energji elektrike për të cilën lëshohen Certifikatat e Origjinës, i nënshtrohen dispozitave të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, Kodit të Pajisjeve Elektrike, Kodit të Shpërndarjes, Rregullave të Tregut dhe çdo kodi ose rregulle tjetër të aplikueshme, përveç rasteve që specifikohen në mënyre eksplicite në këtë Rregull.
- 3 Njësitë gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse janë përgjegjëse për 25% të kostos së debalancit të shkaktuara nga to. Pjesa e mbetur e kostos së debalancit do të mbulohet me Fondin e Energjisë së Ripërtërishme.
- 4 Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i japin prioritet vlerësimit të aplikacionit për kyçje, të dorëzuar nga njësitë gjeneruese që prodhojnë energji elektrike për të cilën lëshohet Certifikata e Origjinës, në mënyrë që të ulet sa më shumë që të jetë e mundur koha e nevojshme për përmbylljen e Marrëveshjes së Kyçjes dhe për përfundimin e kyçjes.
- 5 Operatori i Sistemit të Transmisionit i jep çdo vit ZRRE-së (deri më 30 shtator) një parashikim për koston e ndërlidhur me dispozitat e dhëna në paragrafin 3 për vitin pasues dhe të cilat duhet të mbulohen nga Fondi i Energjisë së Ripërtërishme. Operatori i Sistemit të Transmisionit i raporton ZRRE-së çdo tremujor për nivelin aktual të këtyre kostove.
- 6 Brenda nëntëdhjetë ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, Operatori i Sistemit të Transmisionit i dërgon Zyrës së Rregullatorit për Energji propozimet për ndryshimet e

nevojshme të Kodit të Rrjetit dhe kodeve të tjera teknike për zbatimin e dispozitave që përmban kjo Rregull.

- 7 Brenda nëntëdhjetë ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i dërgon Zyrës së Rregullatorit për Energji propozimet për ndryshimet e nevojshme të Kodit të Shpërndarjes për zbatimin e dispozitave që përmban kjo Rregull.

Neni 20

Ndryshimi i Rregullës

- 1 Propozimi për ndryshim të kësaj Rregulle mund të fillohet prej ZRRE-ja me iniciativë të saj, ose me kërkesë të ndërmarrjeve të energjisë.
- 2 Procedura për aprovimin e ndryshimeve të kësaj Rregulle do të jetë e njëjta me procedurën për miratimin e saj.
- 3 ZRRE-ja gëzon të drejtën që, herë pas here, të nxjerrë udhëzime në lidhje me zbatimin e kësaj Rregulle.

Neni 21

Gjuha zyrtare e Rregullës

Kjo Rregull nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Kjo Rregull do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë kalendarike nga data e aprovimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së

Anëtarët e Bordit

Shtojca 1
Modeli i aplikacionit për Skemën Mbështetëse

Detaje të aplikantit								
Emri								
Adresa								
Personi (personat) kontaktues					Pozicioni			
Nr. Tel.		Nr. faks.		Adresa e email-it				
Detaje të Njësisë Gjeneruese								
Emri					Lokacioni			
Nr. autorizimi (nëse njësia gjeneruese tashmë është autorizuar)					Informacion shtesë			
Kapaciteti i instaluar (MW)					Prodhimi i vjetor i pritshëm (MWh)			
Detaje të burimeve primare energjetike të cilat mund të përdoren për prodhimin e energjisë elektrike								
Burimet primare të Energjisë së Ripërtërishme				Burime të tjera energjetike që përdoren në kombinim				
Burimet	Teknologjia	Lloji	P/J	Burimi	Lloji	P/J		
Erë	Turbina ere			Burimet primare fosile	Ngurta	Qymyr atracit, koks, antracit		
Diellor	Fotovoltaik					Shkëmbinj nafte		
	Termik					Linjiti, briketa linjiti		
Uji	Hidro	Rezervuar				Torfa, briketë torfe		
		Mbi lumë				Tjera		
Gjeotermale					Gaz	Gaz Natyral		
Biomasa	Bimë energjetike					Metan		
	Nënproduktet pyjore dhe bujqësore dhe mbetjet					Gaz i furrave të koksit, gaz i furnaltave dhe gaze të tjera të mbetjeve		
	Biogaz	Gazi i deponive					Gazi i rafinuar, hidrogjeni	
		Gazi i kanaleve të ujërave të zeza					Tjera	
		Të tjera						
Energjia nga nënproduktet dhe mbetjet	Mbetjet komunale të ngurta			Likuide	Benzinë/Diezel			
	Nënproduktet industriale dhe mbetjet komerciale				Mazut			
					LPG			
			Tjera					
				Pjesa e paripërtërishme e mbetjeve				
<p>Aplikimi për njësitë gjeneruese të identifikuar sipas Skemës Mbështetëse sipas rregullave të dhëna në këtë material. Ky aplikim shoqërohet nga një diagram i njësisë gjeneruese në të cilin tregohen detaje të lokacionit të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njehsorëve të eksportit - nënstacionet transformatore - çdo pajisje ndihmëse - çdo njehsor importi 								
Vendi dhe data				Nënshkrimi i autorizuar				